



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.152

dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.785, datë 22.11.2006	Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të strukturës e të nivelit të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Këshillit Kombëtar Kontabilitetit.....	të 6159
Vendim i KM nr.881, datë 20.12.2006	Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme..	6161
Udhëzim i MMPAU nr.6, datë 27.12.2006	Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie	6163
Urdhër i METE nr.931, datë 28.12.2006	Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit.....	6179
Vendim i KMBSH nr.101, datë 27.12.2006	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin nr.52, datë 14.7.2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	6180
Vendim i ERE nr.89, datë 13.12.2006	Për miratimin e rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”.....	6186
Vendim i ERE nr.93, datë 21.12.2006	Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor, kur një klient përfiton statusin e klientit të kualifikuar	6190
Vendim i ERE nr.94, datë 21.12.2006	Për dhënien e licencës për eksportin e energjisë elektrike shoqërisë “Wonder Power” sh.a.....	6191
Vendim i ERE nr.98, datë 22.12.2006	Për fillimin e procedurave për hartimin e modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike.....	6191
Vendim i ERE	Për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së	

nr.99, datë 27.12.2006	statusit të klientit të kualifikuar.....	6192
Vendim i ERE nr.100, datë 27.12.2006	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike.....	6195
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Besnik Arif Verbofshi.....	6198
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Adem Roda.....	6198
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Zenel Zabit Kaferi...	6199

VENDIM
Nr.785, datë 22.11.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË STRUKTURËS E TË NIVELIT TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Struktura organizative e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Organika e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.3, diplomë e shkollës së lartë, të jetë 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë në muaj.
 5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjes nr.3 të jetë në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 6. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjes nr.3, të jetë 0.
 7. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.3.
 8. Paga për pozicionin “Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit” të jetë 31 764 lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë, për punonjësin e punësuar në këtë pozicion, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 10 050 lekë.
 9. Numri i punonjësve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë, gjithsej, 5 veta.
 10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e miratuara për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT



Lidhja nr.2

ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Pozicioni		Numri
Drejtor ekzekutiv		1
Inspektor (për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)	1	
Inspektor (për standardet kombëtare të kontabilitetit)		1
Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit		1
Specialist (financë, arkiv)		1
Punonjës gjithsej		5

Lidhja nr.3

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË
KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Paga mujore					
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor ekzekutiv	II-b	10.050	2%	0	80.342
Inspektor	III-a	10.050	2%	0	59714
Specialist	IV-b	10.050	2%	0	21.714

**VENDIM
Nr.881, datë 20.12.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËR
STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, që gëzojnë të drejtën e gradës, të paguhet në bazë të gradës diplomatike/konsullore, e cila përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si rregull, emërohen:

a) “Përgjegjës sektori”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i dytë” apo të barazvlefshme me të;

b) “Drejtor drejtorie”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i parë” apo të barazvlefshme me të;

c) “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Këshilltar” apo të barazvlefshme me të.

3. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike:

a) “Sekretar i dytë”, në rastin kur emërohet “Përgjegjës sektori” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) “Sekretar i parë”, në rastin kur emërohet “Drejtor drejtorie” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) “Këshilltar”, në rastin kur emërohet “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në rastet kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm, me gradë më të lartë se minimumi i përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të paguhet sipas gradës diplomatike/konsullore, që kanë.

5. Nëpunësit e tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që nuk gëzojnë të drejtën e gradës diplomatike/konsullore, të paguhet sipas akteve nënligjore në fuqi, konkretisht, të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet përkatëse”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

7. Vendimi nr.324, datë 21.5.2004 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR GRADE
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për Vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për Pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	10.050	2%	0	108 570
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër Fuqplotë. Ministër Këshilltar. Konsull i Përgjithshëm.	10.050	2%	0	97 713
Drejtor	Këshilltar.	10.050	2%	0	80 342
Përgjegjës sektori	Sekretar i Parë. Konsull.	10.050	2%	0	59 714
	Sekretar i Dytë. Zëvendëskonsull.	10.050	2%	0	43 428
	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	10.050	2%	0	32 571
	Atashe	10.050	2%	0	21 714

UDHËZIM
Nr.6, datë 27.12.2006

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT PARAPRAK TË NDIKIMEVE

NË MJEDIS TË NJË VEPRIMTARIE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të germës “c” të nenit 66 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e metodologjisë “Për vlerësimin paraprak të ndikimeve në mjedis të një projekti a veprimtarie”, sipas anekseve e pyetësorëve bashkëlidhur si pjesë e udhëzimit.

2. Ky udhëzim orienton: personat fizikë e juridikë, ekspertët mjediorë të certifikuar, organet mjedisore, organet e qeverisjes vendore, publikun, si dhe çdo aktor tjetër të interesuar të zhvillojnë me efektshmëri marrëdhëniet midis tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

3. Zbatimi i kërkesave të metodologjisë, sipas së cilës realizohet procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), synon:

a) thjeshtimin dhe reduktimin e angazhimeve të biznesit, nëpërmjet ndarjes qysh në fillim të projekteve e veprimtarive që do t’i nënshtrohen hartimit të raportit të VNM-së nga ato që nuk kanë nevojë për raport;

b) lehtësimin e procedurave të komunikimit midis propozuesve dhe ekspertëve të certifikuar me organet mjedisore e ato të qeverisjes vendore;

c) unifikimin e rregullave e veprimeve konkrete që zbatohen gjatë procesit;

d) garantimin e rezultateve sa më të besueshme për ndikimet në mjedis, nëpërmjet rritjes së cilësisë së raportit të VNM-së;

e) përputhjen e kërkesave të kësaj metodologjie dhe të veprimeve praktike që kryhen në zbatim të tyre, me ato që përdoren në BE e në vendet anëtare të saj.

4. Metodologjia kërkon që propozuesi të fillojë detyrimisht komunikimet zyrtare me organet mjedisore, me qeverisjen vendore e me publikun e interesuar, për identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis të një projekti apo të një veprimtarie të caktuar, që në fazën e projektidesë.

5. Të zbatuara që në fazën fillestare, kërkesat e metodologjisë bëjnë të mundur:

a) identifikimin e ndërveprimeve dhe ndikimeve të mundshme të projektit me elementet e veçanta të mjedisit sipas informacionit të dhënë në tabelën 1 të aneksit përkatës, bashkëlidhur këtij udhëzimi, çështjet, informacioni mjedisor, si dhe lloji i raportit të VNM-së që përgatitet;

b) vlerësimin sasior të ndikimit në mjedis të veprimtarisë në fazën e zbatimit të saj sipas informacionit të dhënë në tabelën 2, bashkëlidhur, si dhe çështjet e informacioni mjedisor që trajtohen në raportin e VNM-së;

c) përcaktimin e qartë të akteve ligjore dhe nënligjore që propozuesi u referohet për zbatimin e projektit;

d) përcaktimin e qartë të aktorëve të tjerë që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit dhe që duhet të përfshihen në procesin e VNM-së, siç kërkohet në aneksin 3 të këtij udhëzimi;

e) të vlerësohet saktësisht nëse një veprimtari i nënshtrohet ose jo procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pajisjes ose jo me leje mjedisore.

6. Që në fazën e projektidesë, propozuesi i projektit njofton me shkrim Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) në qarkun ku do zbatohet projekti për veprimtarinë që synon të ushtrojë.

7. ARM, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit, i vë në dispozicion propozuesit udhëzimin bashkë me anekset bashkëngjitur, si dhe e orienton mbi mënyrën e plotësimit të tyre.

8. Propozuesi pas plotësimit të kërkesave të udhëzuesit, paraqet në ARM anekset e plotësuara të udhëzuesit, si dhe informacionin e kërkuar në pjesën hyrëse të aneksit I.

9. ARM, brenda 3 ditëve nga dorëzimi i dokumenteve të kërkuara sipas pikës 4.2, shqyrton dhe komunikon me propozuesin për paqartësitë e mundshme në to.

10. Në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve, ARM, brenda 5 ditëve, vendos nëse:

a) veprimtaria nuk ka nevojë t’i nënshtrohet procesit të VNM-së;

b) veprimtaria gjendet në anekset I dhe II të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të VNM-së;

c) veprimtaria do t’i nënshtrohet hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

d) veprimtaria do t’i nënshtrohet hartimit të raportit të përmbledhur të VNM-së;

e) veprimtaria, sipas nenit 28 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor, në të cilin Republika e Shqipërisë është palë, i nënshtrohet procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

11. ARM i komunikon propozuesit vendimin dhe e publikon atë. Ankimi ndaj vendimit të ARM-së bëhet brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së vendimit pranë Drejtorisë së VNM-së dhe lejeve në MMPAU.

12. Ngarkohen Drejtoria e VNM-së dhe e lejeve, agjencitë rajonale të mjedisit dhe ekspertët e certifikuar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
ADMINISTRIMIT TË UJRAVE
Lufter Xhuveli

ANEKSI I

Plotësimi i kërkesave të mëposhtme të tabelës 1 ndihmon përdoruesit të vlerësojnë një projekt që në fazën kur ai është projektide. Vlerësimi realizohet nëpërmjet informacionit të mbledhur nga plotësimi i kërkesave të tabelës 1 bashkëngjitur, duke u bazuar në karakteristikat e projektit dhe mjedisit ku ai synon ta zbatojë. Tabela 1 përmban një sërë pyetjesh që ndihmojnë për të identifikuar nëse do të ketë ndërveprime të mundshme midis projektit dhe mjedisit.

Gjatë plotësimit të kërkesave, përdoruesi duhet të ketë informacionin e domosdoshëm, që përfshin:

- a) kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- b) ndërtimin e objekteve dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;
- c) proceset teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- d) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- e) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre;
- f) gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- g) qendrat e banimit në afërsi të vendndodhjes, ku synon të ushtrohet projekti;
- h) gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit.

Nëse nga plotësimi i kërkesave të kolonës së parë dhe të dytë të tabelës 1, rezultojnë ndërveprime midis projektit dhe elementeve të mjedisit, në kolonën 3 të tabelës duhet të jepet informacion më i sqaruar për mënyrën e ndërveprimit.

Kërkesave të tabelës 1 të aneksit 1 përdoruesi duhet t’u përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të saktë për të lehtësuar një plotësim më të detajuar të tabelës 1 të aneksit 2.

Adresa dhe kontakti i subjektit

Subjekti_____

Selia e subjektit dhe mënyra e kontaktimit_____

Emri i personit përgjegjës_____

TABELA 1

Kjo tabelë përmban një sërë kërkesash që ndihmojnë për të vlerësuar nëse një projekt do të ketë ndërveprime me mjedisin, si dhe për të vendosur nëse një veprimtari do të ketë apo jo ndikime potenciale/thelbësore në elementet përbërëse të mjedisit.

Pyetjet e mëposhtme ndihmojnë për të kthyer përgjigjet e duhura në tabelën e mëposhtme (në kolonën 3) nëse përgjigjja në kolonën e dytë të kësaj table është “Po”.

Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikimin	Po / Jo / ? Përshkruaj shkurtimisht	Do të ketë ndërveprim/ndikim të rëndësishëm? Po / Jo / ?-Përse ?
Gjatë zbatimit të projektit apo ushtrimit të veprimtarisë:		
1. Do të shkaktohen ndryshime fizike në territor (në topografinë, përdorimin e tokës ose burimet ujore etj.)?		
2. Do të përdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, veçanërisht ato burime që nuk janë të rinovueshme ose me pakicë?		
3. Parashikohet përdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin?		
4. Do të prodhohen mbetje të ngurta?		
5. Do të ketë shkarkime në ajër të ndotësve, substancave të rrezikshme, toksike ose helmuese?		
6. Do të ketë zhurma e vibrime apo çlirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?		
7. Do të ketë rrezik për ndotjen e tokës dhe të ujërave nga shkarkimi i ndotësve mbi sipërfaqen e tokës ose të ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose në det?		
8. Ka rrezik për aksidente që mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve apo në mjedis?		
9. Do të ketë ndikime sociale (demografike, në mënyrën tradicionale të jetesës, në punësimin e njerëzve etj.)?		
10. Ka faktorë të tjerë që duhen marrë në konsideratë si zhvillime të njëpasnjëshme që mund të çojnë në pasoja në mjedis apo mundësi për mbivendosje ndikimesh të ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose të planifikuara në zonë?		
11. Ka zona të mbrojtura nga legjislacioni ndërkombëtar/kombëtar për vlerat e tyre të biodiversitetit,		

ekologjike, peizazhistike ose me vlera kulturore, historike e arkeologjike në zonë?		
12. Ka zona të ndjeshme mjedisore, si ligatina, zona bregdetare, male, pyje, kullota, florën e faunën e egër, dru frutorë etj. në zonë?		
13. Ka zona me specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme, të kërcënuara, të rrezikuara, në rrezik zhdukjeje të faunës dhe florës, p.sh. për kryqëzime, folenizime, pushime, dimërim, migrime etj. në zonë?		
14. Ka zona me ujëra tokësore, nëntokësore apo detare në zonë?		
15. Ka zona me tipare të spikatura panoramike ose skenike në zonë?		
16. Ka rrugë apo infrastruktura të ngjashme që përdoren nga publiku për të shkuar në vende pushimi etj. ose rrugë transporti të mbingarkuara që mund të ndikohen?		
17. Ka përdorime ekzistuese të tokës (banim, industri, tregti, pushim, bujqësi, pyje, turizëm, zona të gjelbra, argëtuese, sportive, prona të tjera private etj.) ose plane të ardhshme që mund të ndikohen?		
18. Është zona nën rrezikun e ndotjes ose dëmtimeve mjedisore (ku standardet mjedisore janë të tejkaluara)?		
19. Është zona me probleme përsa i përket tërmete, rrëshqitjeve të dheut, erozionit, përmytjeve, kushteve ekstreme klimatike (ndryshime të temperaturës, mjegulla, erëra të forta)?		

Të bëhet një përmbledhje e shkurtër e tipareve të projektit/veprimtarisë dhe vendndodhjes së tij duke treguar nevojën për të bërë vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Të shënohet më poshtë se ku klasifikohet projekti ose veprimtaria:

VNM e thelluar.

VNM e përmbledhur.

Nuk ka nevojë për VNM .

Shënime.

.....

.....

.....

.....

.....
.....
.....

ANEKSI II
PJESA E PARË

Aneksi 2 synon që, nga informacioni i grumbulluar në tabelën 1 të aneksit I, të analizohet në mënyrë më të detajuar vlerësimi sasior i ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit, të cilat do të merren parasysh në hartimin e raportit të VNM-së.

Mbasi janë identifikuar ndikimet në kolonën 2 të tabelës 1, plotësohet kolona 3 e tabelës, e cila shërben për të vlerësuar ndikimet potenciale të përkohshme, të përhershme apo edhe ato kumulative të veprimtarisë në mjedis.

TABELA 1
IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË VEPRIMTARISË DHE ÇËSHTJET
MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VNM-SË

Nr.	Pyetje që duhet të konsiderohen në fazën e përzgjedhjes	Po/jo	Cilat elemente të mjedisit mund të ndikohen dhe si?	Do të jetë ndikimi, domethënës në mjedis? Pse?
1. A do të përfshijë ndërtimi, operimi ose mbyllja e veprimtarisë dhe çmontimi i teknologjisë dhe pajisjeve të projektit veprime që do të shkaktojnë ndryshime fizike në topografi, përdorim toke, ndryshime në trupat ujorë etj.?				
1.1	Ndryshime të përkohshme ose të përhershme në përdorimin e tokës, mbulesën e tokës ose topografi, duke përfshirë rritjen e intensitetit të përdorimit të tokës?			
1.2	Pastrimin e tokës ekzistuese, vegjetacionit dhe ndërtimeve ekzistuese?			
1.3	Krijimin e përdorimeve të reja të tokës?			
1.4	Investigime para fazës ndërtimore, si shpime për marrjen e mostrave, provat e tokës, dheut?			
1.5	Punime ndërtimi?			
1.6	Punime prishjeje?			
1.7	Kantieri të përkohshme që përdoren për punime ndërtimi ose strehimi për punëtorët e ndërtimit?			
1.8	Punime mbitokësore, struktura ose punime të tokës, përfshirë struktura lineare, ekskavime,			

	gërmime ose mbushje të tyre?			
1.9	Punime nëntokësore, duke përfshirë miniera apo tunele?			
1.10	Punime bonifikuese?			
1.11	Gërmime për hapje kanalesh?			
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?			
1.13	Struktura në det?			
1.14	Procese të ndryshme prodhimi?			
1.15	Mjedise për magazinimin e mallrave dhe materialeve të ndryshme?			
1.16	Impiante për trajtimin ose depozitimin e mbetjeve të ngurta ose shkarkimeve të lëngëta?			
1.17	Objekte për strehim afatgjatë të punëtorëve të shfrytëzimit?			
1.18	Rrugë e re, trafik detar ose hekurudhor gjatë fazës së ndërtimit ose shfrytëzimit?			
1.19	Rrugë e re, hekurudhore, ajrore, ujore ose infrastruktura të tjera transporti, përfshirë dhe rrugë e stacione të reja ose të alternuara, porte, aeroporte etj.?			
1.20	Mbyllje apo devijim i rrugëve ekzistuese ose i infrastrukturës që çon në ndryshime në lëvizjet e trafikut?			
1.21	Linja ose tubacione të reja transferuese të transmetimit?			
1.22	Rezervuarë, argjinatura, kanale nëntokësore, rregullime apo ndryshime të tjera në hidrologjinë e rrjedhave ujore apo akuifereve?			
1.23	Ndërprerje të rrymave?			
1.24	Nxjerrje ose transferim të ujit nga nëntoka ose sipërfaqet ujore?			

1.25	Ndryshime në trupat ujorë ose në sipërfaqet e tokës që ndikojnë në drenazhimin ose largimin e ujërave?			
1.26	Transportin e personelit ose materialeve të ndërtimit, shfrytëzimit ose mbeturinave të veprimtarisë?			
1.27	Punime afatgjata çmontimi, për nxjerrjen e mbeturinave të veprimtarisë ose punime restauruese?			
1.28	Veprimtari gjatë ndryshimit të destinacionit që mund të kenë një ndikim në mjedis?			
1.29	Hyrjen e njerëzve në një zonë përkohësisht ose në mënyrë të vazhdueshme?			
1.30	Futjen për kultivim të specieve jo vendase?			
1.31	Humbjen e specieve vendase ose diversitetit gjenetik?			
1.32	Ndonjë veprim tjetër?			
2. A do të përdoren gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit burimet natyrore të tilla, si: toka, uji, materiale ose energji, ndonjë nga burimet që janë të parinovueshme ose të kufizuara?				
2.1	Tokë veçanërisht e varfër apo toka bujqësore?			
2.2	Uji?			
2.3	Minerale?			
Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes				
2.4	Grumbullime lëndësh ndërtimi (zhavorre etj.)?			
2.5	Pyje dhe lëndë drusore			
2.6	Energjia, përfshirë elektricitetin dhe lëndët djegëse?			
2.7	Ndonjë burim tjetër?			
3. A do të përfshijë projekti përdorimin, ruajtjen, transportin, përpunimin dhe prodhimin e substancave ose materialeve që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njerëzve ose mjedisin dhe që rrisin shqetësimin mbi rreziqet aktuale dhe të mundshme në shëndetin e njerëzve?				
3.1	A parashikon projekti përdorimin e substancave ose materialeve që janë të rrezikshme ose toksike për shëndetin e njeriut dhe mjedisin (florën, faunën, furnizimin me ujë)?			

3.2	Do të rezultojë projekti në ndryshime me shfaqje sëmundjesh ose me efekt në vektorët e sëmundjeve (p.sh. sëmundje që vijnë nga insektet ose infektimet e ujërave)?			
3.3	Do të ndikojë projekti në mirëqenien e njerëzve p.sh. duke ndryshuar kushtet e jetesës?			
3.4	A ka grupe njerëzish (veçanërisht të ndjeshëm) që mund të ndikohen nga projekti p.sh. pacientët e spitaleve, të moshuarit?			
3.5	Shkaqe të tjera ?			
4. A do të prodhohen mbeturina të ngurta nga projekti, gjatë ndërtimit, shfrytëzimit ose nxjerrjes jashtë funksionit?				
4.1	Mbeturina dherash, zhavorri ose minierash?			
4.2	Mbetje urbane (shtëpiake dhe/ose nga tregtia)?			
4.3	Mbetje të rrezikshme ose toksike (përfshi mbetjet radioaktive)?			
4.4	Mbetje të tjera të proceseve industriale?			
4.5	Produkte shtesë?			
4.6	Ujëra të zeza ose llumra të tjera nga trajtimet e shkarkimeve të lëngëta?			
4.7	Mbetjet nga ndërtimet ose shembjet?			
4.8	Mbeturina makinerish ose pajisjesh?			
Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes				
4.9	Toka të ndotura ose materiale të tjera?			
4.10.	Mbetje bujqësore?			
4.11	Mbetje të tjera të ngurta?			
5. A do të shkarkohen ndotës në ajër ose çdo substancë tjetër e rrezikshme toksike ose e dëmshme për shëndetin nga projekti?				
5.1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve fosile, nga burime stacionare ose të lëvizshme?			
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?			
5.3	Shkarkime nga përpunimi i materialeve, përfshi depozitimin ose transportin			

	e tyre?			
5.4	Shkarkime nga aktivitetet e ndërtimit, përfshi impiantet dhe pajisjet?			
5.5	Mbetje ose erëra të këqija nga përpunimi i materialeve, përfshi materialet e ndërtimit, ujërat e zeza dhe mbetjet?			
5.6	Shkarkime nga inceneratorët e plehrave?			
5.7	Shkarkime nga djegia e mbetjeve në ajër të hapur (p.sh. materiale nga prerjet e drurëve, mbetje ndërtimi)?			
5.8	Shkarkime nga burime të tjera?			
6. A do të shkaktojë projekti zhurma dhe vibracione ose emetim të dritës, energjisë termike ose rrezatim elektromagnetik?				
6.1	Nga puna e pajisjeve, si p.sh. motora, impiante ventilimi, thërmues guri?			
6.2	Nga procese industriale ose të ngjashme?			
6.3	Nga ndërtime apo prishje?			
6.4	Nga plasje ose futje pilotash?			
6.5	Nga trafiku gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit ?			
6.6	Nga sistemet e ndriçimit ose ftohjes?			
6.7	Nga burimet e rrezatimit elektromagnetik (merr në konsideratë efektet mbi pajisjet e ndjeshme në afërsi, ashtu si dhe për njerëzit)?			
6.8	Nga çdo burim tjetër?			
7. A do të çojë projekti në rreziqe të ndotjes së tokës ose ujit nga shkarkimet e ndotësve në tokë ose në kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat bregdetare ose në det?				
7.1	Nga përpunimi, depozitimi, përdorimi ose shkarkimi i materialeve të rrezikshme ose toksike?			
7.2	Nga shkarkimet e ujërave të zeza ose rrjedhjeve të tjera (të trajtuara ose të patrajtuara) në ujë ose në tokë?			
7.3	Depozitimi i ndotësve të shkarkuar në ajër, në ujë ose në tokë?			

7.4	Nga çdo burim tjetër?			
7.5	A ka rrezik të ndonjë akumulimi afatgjatë të ndotësve në mjedis nga këto burime?			
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjatë ndërtimit apo shfrytëzimit të projektit që mund të ndikojë në shëndetin e njerëzve apo mjedis?				
8.1	Nga shpërthime, zjarre, nxjerrje etj. nga depozitimi, përdorimi ose prodhimi i substancave të rrezikshme ose toksike?			
8.2	Nga ngjarje që kapërcejnë kufijtë e mbrojtjes normale të mjedisit, p.sh. dëmtimi i sistemit të kontrollit të ndotjes?			
8.3	Nga ndonjë shkak tjetër?			
8.4	Mund të ndikohet projekti nga fatkeqësi natyrore që shkaktojnë dëme për mjedisin (si përmbytje, tërmete, shkarje dheu etj.)?			
9. A rezulton projekti në ndryshime sociale, p.sh. në demografi, mënyrë tradicionale jetese, punësim?				
9.1	Ndryshime në madhësinë e popullsisë, moshën, strukturën, grupet sociale etj.			
9.2	Nga strehimi i njerëzve apo prishja e shtëpive, mjediseve të komunitetit, si shkolla, spitale, mjedise sociale etj.			
9.3	Nëpërmjet migrimit të banorëve të rinj ose krijimit të komuniteteve të reja?			
9.4	Nga realizimi i kërkesave në rritje për mjedise e shërbime sociale, si strehimi, arsimi, shëndeti?			
9.5	Nga krijimi i vendeve të punës gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit apo humbjes së vendeve të punës me pasoja në papunësi dhe ekonomi?			
9.6	Ndonjë shkak tjetër?			
10. A do të çojë projekti në një presion për zhvillime të mëtejshme që mund të kenë një ndikim të				

rëndësishëm në mjedis, për shembull më shumë banesa, rrugë të reja, industri ose veprimtari të tjera mbështetëse etj.?				
10.1	A do të çojë projekti në presione për zhvillime të mëtejshme që do të ketë ndikim të caktuar në mjedis, si: më shumë strehim, rrugë të reja, industri apo shërbime publike mbështetëse të reja?			
10.2	A do të çojë projekti në zhvillimin e mjediseve mbështetëse, në zhvillime ndihmëse ose zhvillime të nxitura nga projekti që mund të ketë ndikim në mjedis, p.sh.: 1. infrastrukturë mbështetëse (rrugë, furnizim me energji elektrike, trajtim i mbeturinave ose ujërave të përdorura etj.); 2. zhvillim i strehimit; 3. industri nxjerrëse (ekstraktuese); 4. industri furnizuese, 5. tjetër?			
10.3	A do të çojë projekti në një ripërdorim të kantierit pas shfrytëzimit të tij që do të ketë një ndikim në mjedis?			
10.4	A do të çojë projekti në krijimin e një precedenti për zhvillime të mëvonshme?			
10.5	A do të ketë projekti pasoja kumulative për shkak të afërsisë me projekte të tjera ekzistuese ose të planifikuara e me pasoja të ngjashme?			

Shënime.

.....
.....
.....
.....
.....
.....

PJESA E DYTË (ANEKSI II)

Karakteristikat e mjedisit ku zhvillohet projekti

Për secilën nga karakteristikat e identifikuara në pjesën I të konsiderohet nëse mund të ndikohet ndonjë nga komponentët e mëposhtëm mjedisorë.

TABELA 2

Pyetje: A ka tipare të mjedisit lokal apo përreth vendndodhjes së projektit, të cilat mund të ndikohen nga projekti? 1. Zona të cilat janë të mbrojtura nga legjislacioni ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor për vlerat e tyre ekologjike, peizazhistike, kulturore dhe vlera të tjera, të cilat mund të ndikohen nga projekti? a) Zona të tjera të cilat janë të rëndësishme ose të ndjeshme për arsye të ekologjisë së tyre, p.sh.: a) ligatina; b) rrjedha ujore ose trupa të tjerë ujorë; c) zona bregdetare; d) male; e) pyje ose woodland. 2. Zona të përdorura nga specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme të florës dhe faunës, p.sh.: për kryqëzim, folenizim, ushqim, pushim, dimërim, migrim që mund të ndikohen nga projekti? 3. Ujërat e brendshme, tokësore, bregdetare, detare dhe nëntokësore? 4. Zona me vlera të larta peizazhistike ose skenike? 5. Rrugë ose mjedise të tjera të përdorura nga publiku për pushime ose aktivitete të tjera? 6. Rrugë transporti që janë të mbingarkuara (mund të kenë probleme trafiku) ose shkaktojnë probleme mjedisore? 7. Zona me rëndësi historike ose kulturore?
Pyetje – Është vendosur projekti në një zonë që mund të jetë shumë e dukshme nga shumë njerëz?
Pyetje - Është i vendosur projekti në një zonë të pazhvilluar më parë, ku do të kemi humbje të tokës së gjelbër?
Pyetje - Ka përdorime ekzistuese të tokës në/ose rreth vendit të zbatimit të projektit, të cilat mund të ndikohen nga projekti? p.sh.: a) shtëpi, oborre ose prona të tjera private;

b) industri; c) tregti; d) rekreacion; e) hapësira publike; f) mjedise të komunitetit; g) bujqësi; h) pyje; i) turizëm; j) karriera ose miniera.
Pyetje - Ka plane për përdorime të ardhshme të tokës në ose rreth vendit të zbatimit të projektit, të cilat mund të ndikohen prej tij?
Pyetje - Ka zona në ose rreth zonës së zbatimit të projektit me një densitet të lartë popullsie ose ndërtimesh, të cilat mund të ndikohen prej tij?
Pyetje - Ka ndonjë zonë në/ose rreth zonës së zbatimit të projektit të zënë nga përdorime të ndjeshme të tokës të cilat mund të ndikohen prej tij? 8. Spitale? 9. Shkolla? 10. Vende kulti? 11. Mjedisë të komunitetit?
Pyetje - Ka ndonjë zonë në dhe rreth projektit e cila përmban burime të rëndësishme, me një cilësi të lartë ose të pakta të cilat mund të ndikohen nga projekti? 12. Burime ujërash nëntokësore? 13. Ujëra sipërfaqësore? 14. Pyje? 15. Bujqësi? 16. Peshkim? 17. Turizëm? 18. Minerale?
Pyetje - Ka ndonjë zonë në dhe rreth zonës së zbatimit të projektit që është aktualisht subjekt i ndotjes ose dëmtimeve mjedisore p.sh. ku standardet ekzistuese mjedisore ligjore janë tejkaluar, të cilat mund të ndikohen nga projekti?
Pyetje - Është zona e zbatimit të projektit e ndjeshme ndaj tërmeteve, rrëshqitjeve të tokës, erozionit, përmblytjeve ose kushteve klimatike të pafavorshme ose ekstreme?
Pyetje - A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në ndryshime në kushtet fizike të ndonjë nga përbërësit e mjedisit? 19. Mjedisin atmosferik, përfshi mikroklimën, kushte klimatike lokale ose të një shkalle më të madhe? 20. Uji – p.sh.: sasia, rrjedhat ose niveli i lumenjve, liqene, ujërat nëntokësore? Grykëderdhjet, ujërat bregdetare ose detare? 21. Toka – p.sh.: sasia, thellësia, lagështia, qëndrueshmëria ose erdibiliteti i tokës? 22. Kushtet gjeologjike dhe të sipërfaqes së tokës?
Pyetje - A ka të ngjarë që shkarkimet nga zbatimi i projektit të ndikojnë në cilësinë e ndonjërit nga përbërësit e mjedisit? 23. Cilësia e ajrit lokal? 24. Cilësia e ajrit global, përfshi ndryshimet klimatike dhe ngushtimin në shtresën e ozonit? 25. Cilësia e ujit: lumenj, liqene, ujëra nëntokësore. Grykëderdhjet, ujërat bregdetare ose detare? 26. Statusi ushqyes dhe eutrofikim i ujërave? 27. Acidifikimi i tokës ose ujërave? 28. Toka? 29. Zhurma? 30. Temperatura, rrezatimet ndriçuese apo elektromagnetike përfshi ndërhyrjet elektrike? 31. Produktiviteti i sistemeve natyrore ose bujqësore?
Pyetje - A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në disponibilitetin apo pamjaftueshmërinë e

burimeve të mundshme në nivel lokal ose global? 32. Karburante? 33. Ujëra? 34. Minerale dhe aggregate? 35. Lëndë drusore? 36. Burime të tjera jo të rinovueshme? 37. Kapacitetin e infrastrukturës në vend: ujërat, ujërat e zeza, prodhimi i energjisë dhe transmetimi i saj, telekomunikacioni, rrugët për depozitimin e mbeturinave, hekurudhat?	
Pyetje - A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në shëndetin ose mirëqenien e komunitetit në zonë? - Cilësinë e ajrit, ujit, ushqimet dhe të çdo produkti tjetër të konsumuar nga njeriu? - Sëmundshmëria ose vdekshmëria e individëve, komuniteteve ose popullsive nga ekspozimi ndaj ndotjes? - Shfaqja ose shpërndarja e bartësve të sëmundjeve, përfshi insektet? - Ndjeshmëria e individëve të veçantë, komuniteteve ose popullatave ndaj sëmundjeve? - Perceptimi individual i sigurisë personale? - Kohezioni dhe identiteti i komunitetit? - Identiteti kulturor dhe shoqatat? - Të drejtat e minoriteteve? - Kushtet e strehimit? - Punësimi ? - Kushtet ekonomike? - Institucionet sociale?	

Shënime.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

PJESA E TRETË (ANEKSI 2)

LISTA E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN E RËNDËSISË SË NDIKIMEVE MJEDISORE DHE SOCIALE

Lista e kriterëve ndihmon përdoruesit për të vendosur nëse një ndikim mund të jetë domethënës dhe duhet të përdoret pas plotësimit të tabelave 1 të aneksit 1 dhe tabelës 1, 2 të aneksit 2.

Pyetjet e mëposhtme duhet të sigurojnë sa më shumë informacion që të jetë e mundur pse efekti konsiderohet domethënës.

Pyetje për t'u marrë në konsideratë:

1. Do të ndodhin ndryshime të mëdha në mjedis?
2. Do të jetë ndikimi dhe pasoja në zonë i pazakonshëm ose kompleks?
3. Do të jetë ndikimi dhe pasoja i shtrirë në një zonë të madhe?
4. Do të ketë ndonjë ndikim të mundshëm ndërkufitar?
5. Do të ndikojë në një grup të madh njerëzish dhe biznesesh?
6. Do të ndikohen specie floristike dhe faunistike me status të veçantë mbrojtjeje?
7. Do të ndikohen burime natyrore me vlera të veçanta?
8. A ekziston rreziku i tejkalimit të standardeve mjedisore?

9. A ekziston rreziku i ndikimit negativ në zonat e mbrojtura?
10. A do të vazhdojë ndikimi për një kohë të gjatë?
11. A do të jetë ndikimi më shumë i përhershëm se i përkohshëm?
12. A do të jetë ndikimi i pakthyeshem?
13. Do të jetë vështirë për ta shmangur, pakësuar, riparuar ose për ta kompensuar ndikimin?

Shënime.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

ANEKSI III

LISTA E KONSULTIMEVE ME PALËT E TJERA

Grupet kryesore të organizatave dhe individët të cilët duhet të konsultohen gjatë procesit të identifikimit (tabela 1 e mëposhtme) janë:

1. Autoritetet mjedisore:
 - a) autoritetet rajonale dhe lokale;
 - b) autoritetet përgjegjëse për kontrollin e ndotjes, përfshi ujin, mbetjet, tokën, zhurmat dhe ajrin e ndotur;
 - c) autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, pasurinë kulturore dhe peizazhin;
 - d) autoritetet shëndetësore;
 - e) autoritetet e kontrollit të përdorimit të tokës, të planifikimit;
 - f) autoritetet në vendet fqinje në rastet e ndikimeve ndërkufitare.
2. Organizata të tjera të interesuara:
 - a) grupet mjedisore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe grupet sociale të interesuara;
 - b) përgjegjësit e departamenteve të qeverisjes për bujqësinë, energjinë, pyjet, peshkimin etj., interesat e të cilëve mund të preken;
 - c) agjencitë ndërkombëtare dhe ndërkufitare, interesat e të cilëve mund të ndikohen, si komisionet e baseneve ujore etj;
 - d) punonjësit lokalë dhe shoqatat e biznesit, si dhoma e tregtisë, shoqatat tregtare etj.
 - e) organizatat e punëdhënësve, si bashkimet tregtare;
 - f) grupe që prezantojnë përdoruesit e mjedisit, p.sh. fermerëve, peshkimit, turistëve dhe grupeve lokale që merren me kafshët e egra;
 - g) institutet kërkimore-shkencore, universitetet dhe qendra të tjera të ekspertizës;
 - h) publiku i zakonshëm.
3. Publiku i zakonshëm:
 - a) pronarët dhe banorët;
 - b) përfaqësues të publikut lokal dhe të gjerë;
 - c) përfaqësues të zgjedhur dhe figura të komunitetit, si përfaqësues të komuniteteve fetare, mësues etj.
 - d) grupet lokale të komunitetit, grupet rezidenciale etj.

TABELA 1
KJO TABELË NDIHMON PËR TË IDENTIFIKUAR AKTORËT E TJERË, TË CILËT MUND TË
PËRFSHIHEN NË PROCESIN E VNM-SË

#	Pala	Roli dhe interesi për projektin	Nevoja për informim dhe konsultim
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

Shënime.

.....

URDHËR
Nr.931, datë 28.12.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë, në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike

a) Për bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:

- Për qytetet e kategorisë së I (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2.000.000 (dy milionë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së II (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së III (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën, 1.000.000 (një milion) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën: 1.000.000 (një milion) lekë

b) Për lojërat aritmetike, që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën: 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

2. Për lojërat e fatit sportive

a) Kategoria "Basti", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 20.000.000 (njëzet milionë) lekë.

b) Kategoria "Konkurs për parashikimet sportive", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

3. Për lotaritë

a) Lotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

b) Lotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë për çdo lotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo lotarie (leje).

4. Lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

Shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit janë të detyruara të plotësojnë fondin e ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve të lojërave të fatit brenda datës 31.1.2007.

Mospagimi i kësaj shume brenda datës 31.1.2007, përbën shkak ligjor për heqjen e lejes së veprimtarisë për këto shoqëri.

Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Licencave dhe e Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Lojërave të Fatit.

Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

VENDIM

Nr.101, datë 27.12.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.52, DATË 14.7.2004 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

I. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin nr.52, datë 14.7.2004 të Këshillit Mbikëqyrës, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Neni 5 pika 5.2 ndryshon si vijon:

“Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit të kredive, në rastet kur:

- gjykohet se interpretimi i kriterëve të mësipërme nga bankat nuk është i drejtë;
- gjykohet se ka elemente të tjera shtesë, përveç karakteristikave të mësipërme, që e justifikojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit.”

2. Neni 6 shkronja a ndryshon si vijon:

“...strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realistë në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.”.

3. Neni 6 shkronja d ndryshon si vijon:

“...procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë. Banka merr masa që proceset e analizës dhe të miratimit të kredisë të jenë të ndara, për të siguruar kontrollin dhe cilësinë e nevojshme në vendimmarrje, si edhe cakton struktura për monitorimin e kredisë në përputhje me madhësinë dhe me larminë e veprimtarisë së kreditimit”.

4. Neni 6 shkronja e ndryshon si vijon:

“...politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, analizën e mospërputhjeve të ndjeshme mes portofolit të kredisë dhe burimeve të financimit të tij përsa i takon afateve dhe llojit të monedhës, në drejtim të vlerësimit të lidhjes mes rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.).

5. Neni 6 shkronja f ndryshon si vijon:

“procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive dhe identifikimin e tyre sipas grupeve të kredive me karakteristika të njëjta, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për rivlerësimin e vazhdueshëm të garancive apo të kolateraleve dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë;

6. Neni 7 pika 7.4 ndryshon si vijon:

“Mënyra e kryerjes së analizës së sigurimit të kredisë, e cila ka për qëllim të vlerësojë nëse një kredi është apo nuk është e siguruar mirë.

Kredia do të konsiderohet e siguruar mirë, në rastin kur:

a) kolaterali ose garancia e përdorur për të siguruar këtë kredi, është e mjaftueshme që të mbrojë bankën nga humbja e kryegjësë dhe e interesit;

b) garancia është e lëshuar nga një subjekt, i cili është juridikisht dhe financiarisht në gjendje të respektojë kushtet e garancisë, megjithë vështirësitë e mundshme financiare të huamarrësit”.

7. Neni 10 pika 7 ndryshon si vijon:

“...kredia është ristrukturuar një herë për shkak të pamundësisë për ta paguar atë dhe plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) megjithë pagesën në përputhje me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 365 ditë nga dita e ristrukturimit.”

8. Neni 11 pika 8, ndryshon si vijon:

“...kredia është ristrukturuar dy herë për shkak të pamundësisë për ta paguar atë dhe plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) që prej ristrukturimit të fundit, kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) megjithë pagesën në përputhje me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 550 ditë nga dita e ristrukturimit të fundit.”

9. Pas nenit 12, shtohet neni i ri 12/1, i titulluar “Ruajtja e klasifikimit”, me përmbajtje si vijon:

“1. Në rastin e kredive të klasifikuara në kategoritë “Nënstandard”, “Të dyshimta” dhe “Të humbura”, banka bën riklasifikimin e një kredie në një kategori më të lartë, vetëm në rastin kur, në bazë të analizave të saj të dokumentuara, rezulton se performanca e kredimarrësit është përmirësuar dhe justifikohet riklasifikimi. Dokumenti i analizës në rastin e riklasifikimit, ruhet në dosjen e kredisë.

2. Gjatë riklasifikimit në rritje të një kredie dhe në përputhje me llojin e saj, banka lejon kohën

e nevojshme, për t'u siguruar që kredimarrësi po shlyen kredinë në përputhje me kushtet e dhënies së saj.”

10. Neni 20 paragrafi i dytë ndryshon si vijon:

Ato hartojnë dhe paraqesin në Bankën e Shqipërisë formularët respektivë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar.

11. Pas nenit 22, shtohen tre nene të reja, si vijon:

A. Neni 22/1, i titulluar “Transparenca me klientin”, me përmbajtje si vijon:

“(1) Për çdo marrëdhënie kreditimi, në llogari ose “zbuluar”, banka dhe huamarrësi nënshkruajnë një kontratë. Në këtë kontratë, banka është e detyruar që minimalisht të përfshijë:

a) objektin e përdorimit të kredisë;

b) llojin e kredisë (me këste, kufi, “zbuluar” etj.);

c) termat e kredisë, që lidhen me vlerën, njësinë monetare, datën e dhënies, datën e maturimit, normën nominale të interesit dhe llojin e saj (e ndryshueshme ose e pandryshueshme), indeksin orientues (norma repo e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, Libor, Euribor etj.), vlerën periodike të shlyerjes së kredisë (kësti), datat ose periudhën e shlyerjes brenda një viti;

d) kontributin fillestar të kredimarrësit (nëse është e zbatueshme) ose komisione të ndryshme për marrjen dhe shlyerjen e kredisë;

e) formën e kolateralit dhe mënyrën e disponimit të tij (nëse është e zbatueshme);

f) detyrimet dhe penalitetet e palëve dhe rastet kur ato lindin dhe zbatohen, veçanërisht kur subjekt i tyre është huamarrësi;

g) mënyrën e ndryshimit të termave të kontratës;

h) mënyrën e përfundimit të kontratës;

i) numrin e kopjeve të nënshkruara në origjinal të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët.

(2) Në procesin e akordimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, banka i ofron kredimarrësit:

j) skedulën e shlyerjeve të kredisë në momentin e disbursimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;

k) skedulën e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë jetës së saj, duke dhënë një shembull të detajuar;

l) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarrësit dhe një shembull i mënyrës së llogaritjes së tyre;

m) një koment ku i tërhiqet vëmendja kredimarrësit për rrezikun që paraqet për të:

- huamarrja në valutë, veçanërisht në rastin kur të ardhurat e tij janë në lek dhe ka lëvizje të pafavorshme të kursit të këmbimit lek/valutë;

- rritja e normës së interesit të kredisë gjatë jetës së saj, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.

(3) Në rastin e kredisë për konsum (duke përfshirë lëshimin e kartave të kreditit) ose në çdo formë tjetër kreditimi në të cilin detyrimi i klientit ndaj bankës lind në formë automatike, kushtet e dhënies, të përdorimit dhe të kthimit të kredisë, së bashku me penalitetet përkatëse duhet të shprehen qartë në dokumentin që lidhet me huamarrësin.”

B. Neni 22/2, i titulluar “Veprimet e administrimit të rrezikut”, me përmbajtje si vijon:

“(1) Në rastin kur ekziston të paktën një prej zhvillimeve të mëposhtme:

a) i) ndryshimi vjetor i raportit të portofolit të kredisë me totalin e aktiveve të bankës në fund të muajve mars, qershor, shtator ose dhjetor, është më i madh se 7 pikë përqindjeje; dhe ii) ndryshimi vjetor i portofolit të kredisë, në fund të muajve mars, qershor, shtator ose dhjetor, është më i madh se 30 për qind; ose kur

b) konstatohet se, si rezultat i zhvillimeve të parashikuara në pikën a) ose në mënyrë të pavarur prej tyre: i) niveli i raportit të “vlerës së kredive me probleme” me “vlerën e kredive (bruto)”, në fund të muajve mars, qershor, shtator ose dhjetor, është më i lartë se 7 për qind por jo më i lartë se 10 për qind; dhe ii) niveli i raportit të “vlerës së kredive me probleme (neto)” me “vlerën e kapitalit rregullator”, në fund të muajve mars, qershor, shtator ose dhjetor, është më i lartë se 25 për qind por jo më i lartë se 35 për qind;

atëherë,

c) banka ponderon me koeficientin e rrezikut 150 për qind, për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (sipas shembullit bashkëlidhur), vlerën më të madhe midis:

i) pjesës së portofolit të kredisë, e cila është rritur mbi masën e përcaktuar në pikën 1 (a) – i;
ii) pjesës së portofolit të kredisë, e cila është rritur mbi masën e përcaktuar në pikën 1 (a) – ii;
iii) pjesës së portofolit të kredive me probleme, e cila rezulton mbi nivelin 7 për qind por nën nivelin 10 për qind, sipas pikës 1 (b) - i;

iv) pjesës së portofolit të kredive me probleme, e cila rezulton mbi nivelin 25 për qind por nën nivelin 35 për qind, sipas pikës 1 (b) - ii;

v) totalit të vlerës së kredisë me probleme pa përfshirë provigjonet, sipas klasifikimit në klasat “nënstandard”, “e dyshimtë” dhe “e humbur”, në rastin kur sipas pikës 1 (b) -i, raporti “vlera e kredive me probleme” me “vlerën e kredive (bruto)” është më i madh se 10 për qind dhe kur sipas pikës 1 (b) –ii, raporti “vlera e kredive me probleme (neto)” me “vlerën e kapitalit rregullator”, është më i madh se 35 për qind.

Banka i identifikon dhe i llogarit këta tregues në mënyrë të vazhdueshme, dhe i dërgon ata në Bankën e Shqipërisë, në fund të çdo tremujori.

d) në pikën 1, paragrafi a):

i) për muajt mars, qershor dhe shtator të vitit 2007, rritja vjetore e portofolit të kredisë do të llogaritet duke marrë si bazë tepricën e kredisë në fund të muajit dhjetor 2006 dhe:

* duke shumëzuar me 4, normën e rritjes së kredisë deri në fund të muajit mars;

** duke shumëzuar me 2, normën e rritjes së kredisë deri në fund të muajit qershor;

*** duke shumëzuar me 4/3, normën e rritjes së kredisë deri në fund të muajit shtator;

ii) për muajin dhjetor 2007 dhe në vazhdim, rritja vjetore e portofolit të kredisë do të llogaritet nëpërmjet krahasimit me vlerën e saj 12 muaj më parë.

(2) Nëse në fund të vitit financiar, banka rezulton me treguesin e llogaritur sipas pikës 1 (b) – i, mbi nivelin 7 për qind, atëherë strukturat drejtuese marrin menjëherë një vendim për krijimin ose shtimin brenda gjashtëmujorit të parë të vitit të ardhshëm, të një fondi të posaçëm rezervë nga fitimi i bankës, jo më pak se 30 për qind e vlerës së diferencës.

(3) Paralelisht, nëse konstatohen shkelje të kërkesave të kësaj rregulloreje, si edhe në vijim të masave sipas paragrafëve 1 (c) dhe 2, strukturat drejtuese të bankës marrin një ose disa prej masave të mëposhtme:

a) monitorim i përforcuar i kredive me probleme, si edhe raportim mbi gjendjen e tyre çdo muaj në Bankën e Shqipërisë. Raportimi do të përfshijë ndarjen e kredive me probleme sipas grupeve që kanë karakteristika të njëjta (lloji, afati, monedha, sektori, gjeografia etj.);

b) kufizim/ndërrprerje e transmetimit në media, të promocioneve që synojnë afrimin e publikut me oferta për kreditim;

c) rishikim i objektivave, me qëllim kufizimin e ritmit të rritjes së kreditimit të bankës gjatë vitit, në tërësi ose sipas karakteristikave të saj (që lidhen me shpërndarjen sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas llojit, sipas afateve, sipas monedhave, sipas normës së interesit etj.);

d) zbatim i vlerave jo më të mëdha se 25 për qind, për raportin “pagesë e kredisë (e këstit ose e shumës së shërbimit të borxhit)/të ardhura të disponueshme” të kredimarrësit, veçanërisht në rastin e kredisë për konsum;

e) zbatim i vlerave sasiore më të ulëta në raportin “vlerë e kredisë/vlerë e kolateralit”, në çdo rast jo më të larta se 70 për qind;

f) pezullim i shpërndarjes së dividendëve;

g) shtim i menjëhershëm i kapitalit të bankës dhe ndërmarrja e veprimeve të tjera, në mënyrë që të arrihet dhe të ruhet niveli minimal i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas përcaktimit në kuadrin rregullativ.

(4) Për veprimet e ndërmarra sipas paragrafëve 1 (c), 2 dhe 3 të këtij neni, bankat njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë. Njoftimi shoqërohet me një përshkrim të masave të marra, efektet e pritshme të tyre në zhvillimin e portofolit të kredisë, ndikimin e tyre në treguesit kryesorë të veprimtarisë së bankës që lidhen me kapitalin, përfitueshmërinë dhe likuiditetin, si edhe masat e tjera korrigjuese që banka po shqyrton (nëse ka).

(5) Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë ka të drejtë t’i kërkojë strukturave drejtuese të bankës të zbatojnë masat e përcaktuara në paragrafët 1 (c), 2 dhe 3 më sipër, si edhe masa të tjera që gjykohen të nevojshme për përmirësimin e situatës, nëse konstatohet që strukturat drejtuese

të bankës kanë vepruar me vonesë dhe në mënyrë të pamjaftueshme.

(6) Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë strukturave drejtuese të bankës që në llogaritjen e normave dhe të treguesve të përcaktuar në këtë nen, të përfshijnë edhe zëra të tjerë që regjistrohen brenda ose jashtë bilancit të bankës, nëse gjykohet që ato përfaqësojnë një formë kreditimi ose angazhimi për kreditim dhe kufizimi i rritjes së tyre është në frymën e kërkesave të këtij neni.”

C. Neni 22/3, në pjesën “Dispozita përfundimtare”, me përmbajtje si vijon:

(1) Për kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas nenit 22/1, banka merr masa për zbatimin e menjëhershëm për të gjithë kredimarrësit e rinj të bankës. Banka njofton kredimarrësit ekzistues, nëpërmjet njoftimit me postë dhe/ose publikimit të kërkesave rregullative në mjediset e saj, që frekuentohen nga publiku.

(2) Për kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas nenit 22/2, pika 1, paragrafët (a) dhe (b), banka merr masa për identifikimin dhe monitorimin e menjëhershëm të tyre dhe raportimin në Bankën e Shqipërisë, duke filluar nga muaji mars 2007.

(3) Për kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas nenit 22/2 pika 2, banka merr masa për zbatimin e tyre, mbi bazën e të dhënave të llogaritura në muajin dhjetor 2007 dhe në vazhdim.

(4) Pavarësisht nga përcaktimet e mësipërme, Departamenti i Mbikëqyrjes ka të drejtë të shqyrtojë mundësinë dhe të vendosë për përjashtimin nga zbatimi i kërkesave të nenit 22/2, pika 1 paragrafi (c) dhe pika 2, të bankave që janë në vitin e parë të veprimtarisë së tyre, pas kërkesës së tyre dhe në rastin kur konstatohen deformime logjike në zbatimin e treguesve.

(5) Të gjitha bankave që, si rezultat i zbatimit të kërkesave të nenit 22/2 pika 1, në muajin mars 2007 rezultojnë me shkelje të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, u lihet afat për plotësimin e kapitalit deri në fund të muajit qershor 2007.

(6) Të gjitha kërkesat (ndryshimet) e tjera të kësaj rregulloreje, që nuk përmenden në paragrafët e mësipërme të këtij neni, hyjnë në fuqi në muajin janar 2007.

12. Shtohet tabela “SHEMBULLI, për llogaritjen e treguesve sipas nenit 22/2”, sipas përmbajtjes dhe formatit bashkëlidhur, së bashku me shënimet sqaruese.

II. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Fullani

SHEMBULL për llogaritjen e treguesve sipas nenit 22/2:

Banka X				
Nr	Treguesit (milione lekë)	Projektimi Muaji		Muaji dhjetor 2006
		Dhjetor 2007	Mars 2007	
		a	b	c
1	Totali i aktiveve (mln.lekë)	110,000	102,500	100,000
2	Teprica bruto e kredisë	35,000.00	26,750.00	24,000.00
3	Teprica neto e kredise		24,375.00	23,500.00
4	Kredi me probleme bruto		1,975.00	1,800.00
5	Kredi me probleme neto		1,400.00	1,300.00
6	Kapitali rregullator		5,100.00	4,800.00
7	Rritja e tepricës bruto te kredisë (2a) - (2c)	11,000.00		
8	(2a) - (((2c/1c)+7%)*(1a)))	900.00		
9	(7a) - (30%*(2c))	3,800.00		
10	(4b) - (7% *(2b))	102.50		
11	(4b) - (10% *(2b))	(700.00)		
12	(5b) - (25% * (6b))	125.00		
13	(5a) - (35% * (6a))	(385.00)		
14	Identifikimi i vlerës që ponderohet me 150 për qind			
	1. Nëse (8a) ≤ 0 ose (9a) ≤ 0, atëherë 0 dhe 2. Nëse ((8a) > 0 dhe (9a) > 0), dhe ((8a) - (9a) ≠ 0), atëherë, nëse (8a) > (9a), zgjidhet (8a), përndryshe (9a).	3,800.00		
	1. Nëse (10a) ≤ 0 ose (12a) ≤ 0, atëherë 0 dhe 2. Nëse ((10a) > 0 dhe (11a) < 0), dhe ((12a) > 0 dhe (13a) < 0), atëherë, nëse (10a) > (12a), zgjidhet (10a), përndryshe (12a).	200.00		
	1. Nëse (11a) < 0 ose (13a) < 0, atëherë 0 dhe 2. Nëse ((11a) => 0 dhe (13a) => 0), atëherë zgjidhet (5a).	-		
15	Zgjidhet vlera më e madhe në pikën 14	3,800.00		
16	Shtesa e aktiveve te ponderuara me rrezikun			
	3800*150%-3800*100%	1,900.00		

Shënime sqaruese:

1. Teprica bruto e kredisë sipas bilancit jepet pa zbritjen e provigjoneve për humbjen nga kredia dhe konsideron (+) interesat e llogaritur.

2. Teprica neto e kredisë sipas bilancit konsideron zbritjen (-) e provigjoneve për humbjen nga kredia dhe (+) interesat e llogaritur.

4. Teprica bruto e kredisë me probleme jepet pa zbritjen e provigjoneve për humbjen nga kredia dhe konsideron (+) interesat e llogaritur.

5. Teprica neto e kredisë me probleme sipas bilancit konsideron zbritjen (-) e provigjoneve për humbjen nga kredia dhe (+) interesat e llogaritur.

Sqarime lidhur me mënyrën e llogaritjes së shtesës së aktiveve të ponderuara me rrezikun.

- Llogaritja e rritjes së totalit të kredisë dhe totalit të aktiveve për vitin 2007 bëhet duke supozuar një rritje të njëtrajtshme të tyre përgjatë tremujorëve. Kështu nëse totali i kredisë gjatë tremujorit të parë rritet me X%, atëherë projektohet që rritja vjetore do të jetë $X \cdot 4$. Kjo gjë bëhet për të shmangur efektin prapaveprues që do të kishte nëse do të merrnim në konsideratë rritjen në terma vjetorë për shembull mars 2006 deri në mars 2007. Ndërsa, përsa i përket totalit të aktiveve me probleme bruto, aktiveve me probleme neto dhe kapitalit rregullator, merret vlera më e fundit e tyre.

- Vlera, e cila do të ponderohet me 150% do të jetë vlera më e madhe e tejkallimeve sipas pikës 15.

- Aktivët e ponderuara me rrezikun do të shtohen me një zë të veçantë, i cili do të pasqyrohet në tabelën e aktiveve të ponderuara me rrezikun. Ky zë do të quhet “shtesë e aktiveve të ponderuara me rrezikun, për shkak të nenit X të rregullores së kredisë”.

- Shtesa e aktiveve të ponderuara do të bëhet në këtë mënyrë:

Totali i vlerave të llogaritura sipas pikas 15 ponderohet me 150% dhe i hiqet ponderimi i tyre i mëparshëm. Do të supozohet që ponderimi i mëparshëm për këtë vlerë ka qenë 100%, pra efekti neto i shtesës së aktiveve të ponderuara me rrezikun do të jetë 50% e vlerës së llogaritur në pikën 15.

- Nëse në periudhën pasardhëse Banka nuk ka thyerje të kufijve, atëherë zëri “shtesë e aktiveve të ponderuara me rrezikun për shkak të nenit X të rregullores së kredisë” bëhet zero.

VENDIM

Nr.89, datë 13.12.2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT”

Mbështetur në nenet 9 dhe 20 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2006, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLORE

E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT

PJESA E PARË **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 20 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në zbatim të vendimeve të Bordit të Komisionerëve të ERE-s për miratimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, në aktivitetin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilët paraqesin në ERE kërkesën për shitje, dhënie me qira, transferim apo ndryshime të tjera të çdo aseti ose të pronësive të përcaktuara për prodhim, transmetim, shpërndarje të energjisë elektrike.

Neni 3

Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen nga ERE, si dhe parimet për shqyrtimin e çdo kërkesë për shitje, dhënie me qira, transferim apo ndryshime të tjera të çdo aseti ose të pronësive të përcaktuara për prodhim, transmetim, shpërndarje të energjisë elektrike sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 4

Zbatimi

1. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët kërkojnë të transferojnë asetet e prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes sipas përcaktimeve të ligjit.

2. Për të licencuarit në aktivitetin e prodhimit do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim asetesh për kapacitet të instaluar më të madh se 500 kw. Për të gjithë të licencuarit e tjerë do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve, kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 5.000.000 lekë.

3. Për transferimin e aseteve që realizohet në kuadër të procesit të privatizimeve në sektorin publik, nuk do të aplikohet kjo rregullore.

4. Kërkesa për transferim biznesi nga të licencuarit do të rregullohet sipas procedurave të përcaktuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit.

Neni 5

Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj” do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” me të gjitha ndryshimet.

2. “Bordi i Komisionerëve” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligji nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.

4. “Licencë” do të thotë një autorizim që i jepet një personi sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

5. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë sipas pjesës së tretë të

ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6. “Procedurë” do të thotë tërësia e veprimeve që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

7. “Aset” do të thotë aktivi afatgjatë material që trajtohet nga i licencuari dhe që i shërben realizimit të një prej aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit.

8. “Transferim asetesh” do të thotë çdo veprim, me anë të të cilit krijohet një marrëdhënie qiraje, shitjeje, dhënie, pengu apo ndryshimi tjetër të aseteve që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

9. “Biznes” do të thotë aktiviteti i licencuar nga ERE për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E PARAQITJES SË NJË KËRKESË PËR TRANSFERIM ASETESH

Neni 6

Propozimi për fillimin e një procedure për transferim asetesh

Një procedurë për transferim asetesh fillon me paraqitjen nga një person mbajtës i një licence të dhënë nga ERE të një kërkesë për shitje, dhënieje me qira, pengu, transferimi apo ndryshime të tjera të çdo aseti që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

Neni 7

Përmbajtja e kërkesës për transferim

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për transferim asetesh duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:

1. emrin e plotë të të licencuarit;
2. adresën e saktë të të licencuarit apo të personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numër telefoni, fax-i dhe adresa e postës elektronike nëse ka;
3. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:
 - a) të gjitha bizneset e të licencuarit;
 - b) veprimtarinë e licencuar;
 - c) gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;
 - d) një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aseti, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare;
 - e) arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit;
 - f) efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit;
 - g) efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar;
 - h) marrëveshje paraprake midis palëve për transferimin e aseteve.
2. Kërkesat e nenit 7, germa “a” dhe “c”, përbëjnë detyrim edhe për kandidatin e propozuar për transferim.

3. Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar.

4. Nëse Bordi i Komisionerëve e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë informacion shtesë nga i licencuari, i cili duhet ta dërgojë informacionin e kërkuar brenda 8 ditëve nga marrja e njoftimit.

5. Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre.

Neni 8

Shqyrtimi i kërkesës

1. Fillimi i shqyrtimit të kërkesës do të nis[pas marrjes së vendimit nga Bordi i Komisionerëve për fillimin ose jo të procedurave të shqyrtimit, sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 9

Verifikimi i dokumentacionit dhe informacioni shtesë

1. Bordi i Komisionerëve mund të ngarkojë një ose më shumë persona për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura nga i licencuari, duke bërë inspektimin në vend.

Neni 10

Afati i shqyrtimit të kërkesës

1. Shqyrtimi i kërkesës për transferim do të bëhet brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.

2. Në rast se dokumentacioni nuk është dërguar konform nenit 7, por është marrë vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni do të fillojë nga dita e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të kërkuar nga ERE. Nëse pas marrjes së vendimit informacioni nuk dërgohet brenda 2 muajve, atëherë vendimi për fillimin e procedurave e humbet fuqinë juridike dhe i licencuari do të paraqesë një kërkesë të re në ERE.

3. Në rastin e transferimit të aseteve nga shoqëria e transmetimit, shpërndarjes dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centralet me kapacitet më të madh se 10 MW, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është 90 ditë.

Neni 11

Parimet për miratimin e kërkesës për transferim

1. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, Bordi i Komisionerëve do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për transferim, duke e bazuar vendimin e tij në parimet dhe kriteret si më poshtë:

- a) dëmtimi i interesave publike nga transferimi;
- b) gatishmëria e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
- c) ndikimi i transferimit në gjendjen financiare të të licencuarit, si dhe të personit të propozuar për ndryshim, (Mban në të njëjtën nivel, përmirëson apo përkeqëson gjendjen financiare);
- d) ndikimi i transferimit në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të aktivitetit të licencuar;
- e) ndikimi i transferimit në tarifat e shërbimit për klientët tariforë dhe ndikimi në përfitimet për ata;
- f) ndikimi i transferimit në konkurrencën e pjesëmarrësve të tregut;
- g) ndikimi i transferimit në ekonominë e komunitetit, në rastin e kompanive publike;
- h) mundësia financiare dhe teknike e personit të propozuar për transferim, për të vazhduar operimin e aseteve dhe kryerjen e riparimeve të tyre, nëse janë të nevojshme;
- i) mundësinë e personit të propozuar për transferim për të mbuluar efektin financiar në rritjen e tarifave që mund të shkaktohet nga transferimi i aseteve.

Neni 12

Njoftimi për vendimin

1. Në përfundim të procedurës për transferim aset, brenda 5 ditëve, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve, si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit.

2. Vendimi i Bordit të Komisionerëve për kërkesën për transferim asetesh do të publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 13
Ankimi gjyqësor

Kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve për transferim asetesh, i licencuari mund të bëjë ankimin në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14
Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.93, datë 21.12.2006

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR, KUR NJË KLIENT PËRFITON
STATUSIN E KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9, 48, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2006, pasi shqyrtoi relacionin e për gatitur,

VENDOSI:

1. Niveli i konsumit të energjisë elektrike për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, nga data 1.1.2007 deri më 31.12.2007, do të jetë mbi 10 GWh për vend konsumi.

2. Klienti me konsumin e shprehur në pikën 1 të këtij vendimi mund të aplikojë në ERE për të marrë statusin e klientit të kualifikuar.

3. Përfitimi i statusit të klientit të kualifikuar do të kryhet në përputhje me rregulloren “Për kriteret e dhënies dhe heqjes të statusit të klientëve të kualifikuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.94, datë 21.12.2006

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR EKSPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË
“WONDER POWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1 germa “d”, nenit 15, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.37, datë 9.7.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, nenet 4, pika 1 germa “f”, dhe 5,

pika 1, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Wonder Power” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

I. Dhënien e licencës për eksportin e energjisë elektrike “Wonder Power” sh.a., me një afat kohor nga data 1.1.2007 – 31.12.2007.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.98, datë 22.12.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E MODELIT SHQIPTAR TË
TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 15, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse, nenit 11 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004, i ndryshuar me vendimin nr.25, datë 27.5.2005 “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 22.12.2006, pasi analizoi draftin e modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike, i hartuar nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Miratimin e fillimit të procedurave për hartimin e modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.99, datë 27.12.2006

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË
STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.12.2006, pasi shqyrtoi draftin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLORE
PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR

KAPITULLI I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore hartohet në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 48, të ndryshuar dhe ka për qëllim vendosjen e rregullave për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.

Neni 2
Zbatimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë klientët tariforë, që përfitojnë statusin e klientit të kualifikuar sipas nenit 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe sipas kësaj rregulloreje.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë rregullore termet e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
2. “Bordi i Komisionerëve” është organi vendimmarrës i ERE-s i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.
3. “Furnizues i kualifikuar” është personi i licencuar për të furnizuar një ose më shumë klientë të kualifikuar.
4. “Klientë i kualifikuar” është klienti që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e energjisë elektrike.
5. “Shoqëri shpërndarjeje” është personi i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar.
6. “Shoqëri transmetimi ose operatori i sistemit të transmetimit” është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike.
7. “Furnizuesi publik” është personi i licencuar për të furnizuar klientët tariforë.
8. “Klienti tarifor” është klienti, që furnizohet nga furnizuesi publik me çmime dhe tarifa të rregulluara.
9. “Nivel i konsumit vjetor” sasia e energjisë elektrike që një klient duhet të konsumojë gjatë një viti, e përcaktuar nga Bordi i Komisionerëve brenda muajit janar të çdo viti.

KAPITULLI I DYTË
KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR

Neni 4
Kriteret për dhënien e statusit

Ka të drejtë të kërkojë statusin e klientit të kualifikuar konsumatori që plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje si më poshtë:

- a) Ka konsumuar gjatë vitit të mëparshëm nga viti kur aplikon një sasi energjie elektrike të barabartë ose më të madhe nga kufiri i nivelit të konsumit të miratuar nga Bordi i Komisionerëve.

b) Paraqet në ERE kopje të noterizuar të librezës së pagesave të energjisë elektrike dhe kopje të faturave të energjisë elektrike, të noterizuara, për vitin e mëparshëm, sipas të cilave ka likuiduar detyrimet ndaj furnizuesit publik deri në momentin që aplikon.

c) Demonstron në ERE se gjatë vitit që aplikon do të konsumojë sasinë e energjisë elektrike të barabartë ose më të madhe nga kufiri i nivelit të konsumit të miratuar nga Bordi i Komisionerëve.

Neni 5

Regjistrimi i kërkesës dhe vendimi i Bordit

1. Çdo klient i energjisë elektrike, që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, së cilës i bashkëngjit dokumentet që provojnë plotësimin e kriterëve për përfitimin e statusit.

2. Në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve do të shprehet me vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kësaj kërkesë.

3. Brenda 20 ditëve nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, Bordi i Komisionerëve do të vendosë për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar, i cili bëhet efektiv vetëm nëse klienti plotëson kërkesat e nenit 6.

Neni 6

Bërja efektive e statusit

1. Pas marrjes së statusit të klientit të kualifikuar, klienti duhet të njoftojë 90 ditë përpara planifikimit për bërjen efektive të statusit, furnizuesin dhe ERE-n.

2. Klienti i kualifikuar, pas bërjes efektive të statusit, mund të lidhë kontratë për furnizimin me energji elektrike me çdo furnizues të kualifikuar.

KAPITULLI I TRETË

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HEQJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR

Neni 7

Heqja e statusit të klientit të kualifikuar

Statusi i klientit të kualifikuar hiqet kur:

- a) klienti deklaron se heq dorë nga statusi i dhënë;
- b) nuk plotëson nivelin e konsumit për vitin pas marrjes së statusit;
- c) nuk përmbush detyrimet ndaj operatorit të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes;
- d) nuk zbaton legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Heqja e statusit me kërkesë të klientit

1. Në rastet kur klienti i kualifikuar do të zgjidhë kontratën me furnizuesin e kualifikuar dhe do të lidhë kontratë për furnizimin me energji elektrike me furnizuesin publik, si klient tarifor, duhet që 2 muaj përpara të bëjë kërkesë me shkrim pranë ERE-s dhe të njoftojë furnizuesin publik, që dëshiron të kthehet si klient tarifor.

2. ERE do të marrë vendim për heqjen e statusit brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në ERE të kërkesës së klientit të kualifikuar për t'u kthyer në klient tarifor.

3. Brenda 5 ditëve nga heqja e statusit të klientit të kualifikuar, ERE njofton furnizuesin publik për vendimin e saj.

Neni 9

Heqja e statusit me iniciativën e ERE-s

Për të gjitha rastet e heqjes së statusit të klientit të kualifikuar me iniciativën e ERE-s, do të ndiqet procedura si më poshtë:

a) Bordi i Komisionerëve, në bazë të informacionit të përgatitur nga stafi teknik i ERE-s, do të shprehet me vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit.

b) ERE do të njoftojë, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave, klientin për procedurën e filluar prej tij dhe shkaqet që kanë shërbyer për inicimin e procedurës për heqjen e statusit.

c) Brenda 20 ditësh, klienti i kualifikuar do të shprehet në ERE mbi vendimin e ERE-s dhe nëse ka pretendime për të.

d) ERE do të marrë vendim për heqjen e statusit vetëm pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin “c” të këtij neni, por jo më vonë se 45 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të heqjes së statusit.

KAPITULLI I KATËRT DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

Rilidhja e kontratës së furnizimit me energji elektrike me furnizuesin publik

Brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës nga klienti, furnizuesi publik detyrohet të lidhë kontratën e furnizimit me energji elektrike me klientin sipas modelit të kontratës së miratuar nga ERE për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë.

Neni 11

Rinovimi i statusit

1. Klienti që ka fituar gjatë një viti statusin e klientit të kualifikuar, nëse kërkon të mbajë statusin e dhënë duhet të paraqesë kërkesë me shkrim në ERE dhe t'i bashkëlidhë asaj dokumentet që vërtetojnë sasinë e konsumuar gjatë vitit.

2. Pas regjistrimit të kërkesës, ERE do të analizojë dokumentet e dërguara dhe do të marrë vendim brenda 30 ditëve të regjistrimit të kërkesës në ERE.

Neni 12

Ndryshimi i rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM Nr.100, datë 27.12.2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË SHKËMBIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 8, pika 2 germa “1”, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.12.2006, pasi shqyrtoi draftin e rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Neni 1 **Autoriteti**

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.9626, datë 16.10.2006 “Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, të ndryshuar.

Neni 2 **Qëllimi**

Të sigurojë rregulla dhe procedura të thjeshtuara për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e shkëmbimeve të energjisë elektrike, në rastet kur e kërkon situata energjetike, duke garantuar furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve.

Neni 3 **Përcaktime**

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, i cili është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike.
2. “Shkëmbim i energjisë elektrike” do të thotë kalimi i ndërsjellë në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike, si dhe tërësia e veprimeve të kryera në rrethanat e mungesës/tepricës së energjisë elektrike nga kompania publike e gjenerimit në kushtet e një situatë energjetike të paparashikuar në programin vit/muaj/javë/ditë në avancë. Në kuptim të kësaj rregulloreje, shitja dhe blerja në treg e energjisë nuk përbëjnë shkëmbim të energjisë elektrike.
3. “Situatë energjetike e paparashikuar” është gjendja energjetike që sjell devijime nga

programi vit/muaj/javë/ditë në avancë, për shkak të tepricave në prodhim apo dhe mungesave në prodhim ose importin e planifikuar gjatë vitit.

4. “Kandidat” do të thotë një person fizik ose juridik i ftuar për të marrë pjesë ose shpreh interes për të kontraktuar me KESH sh.a. për shkëmbim të energjisë elektrike.

5. “Ftesë për shkëmbim”, dokumenti me anë të cilit KESH sh.a. u drejtohet kandidatëve të ndryshëm e që publikohet detyrimisht në faqen elektronike të KESH sh.a.

6. “Urdhri për kryerjen e procedurave të shkëmbimit”, akt juridik i Drejtorit të Përgjithshëm të KESH sh.a. që përcakton të dhëna të karakterit teknik ekonomik, si dhe përcakton komisionin që do të ndjekë zbatimin e urdhrin.

7. “Oferta”, tërësia e dokumenteve, të dërguara me postë, fax ose dorazi, me anë të së cilës një kandidat i përgjigjet ftesës për shkëmbim të KESH sh.a.

8. “Terma komerciale”, tërësia e elementeve, që kanë të bëjnë me koeficientët e shkëmbimit të energjisë elektrike, kushtet (pikat) e livrimit, trajtimi i humbjeve në tranzitim, si dhe penalitetet për mospërbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Neni 4 Zbatimi

Shkëmbimi i energjisë elektrike do të bëhet në rastet e mungesave/tepricave të energjisë, që diktohen nga situatat energjetike të paparashikuara në programin vjetor nga shoqëria publike KESH sh.a.

Nevojat për shkëmbimin e energjisë balancuese dhe shkëmbimi ditor, me qëllim optimizimin e sistemit energjetik, nuk janë objekt i këtyre rregullave.

Neni 5 Parimet e shkëmbimit të energjisë elektrike

1. Shkëmbimi i energjisë elektrike do të kryhet në bazë të parimeve të transparencës dhe të efikasitetit ekonomik, që lidhet jo vetëm me transaksionin e kryer, por me gjithë aktivitetin në tërësi të shoqërisë publike KESH sh.a.

Neni 6 Marrëveshjet e shkëmbimit

Shkëmbimi i energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë publike KESH sh.a. dhe shoqërive që ofrojnë energji elektrike për shkëmbim, në kuptim të nenit 3 të mësipërm, kryhet sipas rastit, në përputhje me:

a) marrëveshjet shtetërore të lidhura midis Qeverisë Shqiptare dhe qeverive të vendeve përkatëse;

b) marrëveshjet paraprake ndërmjet shoqërisë publike dhe kompanive që ofrojnë energji elektrike për shkëmbim;

c) marrëveshjet e palëve që rrjedhin nga negociatat korente të shoqërisë publike me shoqëritë (Furnizues/tregtarë të huaj ose vendas ose shoqërive publike të rajonit), që ofrojnë energji elektrike për shkëmbim.

Neni 7 Kërkesa

Për çdo shkëmbim, shoqëria publike KESH sh.a. harton kërkesën me termat përkatës për shkëmbimin e energjisë elektrike. Kërkesa përmban:

- sasinë e energjisë elektrike MW/h;
- grafikun ditor të livrimit;
- kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë;
- periudhat e shkëmbimit (marrje/dhënie).

Neni 8
Miratimi i shkëmbimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a. i propozon këshillit mbikëqyrës të shoqërisë nevojën vjetore për shkëmbimet për situata të paparashikuara. Këshilli mbikëqyrës i miraton ato në programin vjetor të zhvillimit të shoqërisë.

2. Sasia e energjisë elektrike neto e shkëmbyer ndërmjet asaj të dhënë dhe asaj të marrë gjatë një viti nuk duhet të jetë më shumë se 4 % e totalit të furnizimit vjetor të vitit pasardhës. Mbi këtë bazë shoqëria do të veprojë gjatë vitit në mënyrë operative.

3. Këshilli mbikëqyrës do të informohet në mënyrë periodike nga shoqëria për çdo operacion shkëmbimi të kryer dhe do të veprojë sipas kompetencave që i jep statuti.

Neni 9
Procedura e shkëmbimit

1. Në bazë të kërkesës për shkëmbim, Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a. nxjerr urdhrin për kryerjen e procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike. Urdhri do të përmbajë, të paktën:

- sasinë e energjisë elektrike MW/h;
- grafikun ditor të livrimit;
- kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë;
- periudhat e shkëmbimit (marrje/dhënie);
- komisionin e kryerjes së procedurave të shkëmbimit.

2. Komisioni përgatit ftesën për shkëmbim që u drejtohet në mënyrë të dokumentuar të gjithë shoqërive (furnizues/tregtarë të huaj ose vendas, ose shoqërive publike të rajonit), që ofrojnë energji elektrike për shkëmbim dhe përmban kërkesat e përcaktuara në nenin 7, si dhe termat komerciale të shkëmbimit dhe afatin e dorëzimit të ofertave. Kjo kërkesë publikohet në faqen elektronike të KESH sh.a. në po të njëjtën ditë që u drejtohet shoqërive të ndryshme nga KESH sh.a.

3. Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për shkëmbim, komisioni do të pranojë ofertat e kandidatëve të ndryshëm dhe do të lejojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre gjatë njohjes me ofertat. Komisioni do të vlerësojë, jo më vonë se 24 orë nga pranimi i tyre, ofertat e paraqitura dhe do të zgjedhë ofertën më të leverdisshme.

4. Në kushtet e paraqitjes së vetëm një oferte, komisioni do të procedojë me pranimin dhe vlerësimin e leverdisshmërisë së saj për KESH sh.a.

5. Në çdo rast komisioni do t'i paraqesë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm një raport përmbledhës të kryerjes së procedurave dhe një analizë të ofertës së përzgjedhur, duke argumentuar leverdisshmërinë e saj.

6. Mbi bazë të raportit përmbledhës të komisionit, Drejtori i Përgjithshëm, jo më vonë se 24 orë nga marrja e raportit përmbledhës, shpall ofertën fituese.

7. Komisioni do të mbajë procesverbal për çdo veprim procedural të kryer në funksion të procedurës së shkëmbimit dhe ka përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga të interesuarit.

8. Brenda një periudhe jo më shumë se 24 orë nga marrja e vendimit për shpalljen e ofertës fituese, KESH sh.a. do të negociojë për lidhjen e kontratës me ofertuesin fitues. Nëse ofertuesi fitues refuzon të lidhë kontratën për shkëmbimin e energjisë elektrike, atëherë KESH sh.a. do të procedojë me negocimin për lidhjen e një kontrate me ofertuesin e radhës.

9. I gjithë dokumentacioni, së bashku me kontratën e lidhur midis KESH-it dhe ofertuesit fitues, do të regjistrohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Deklarata e konfliktit të interesave

Pas pranimin të ofertave, çdo anëtar i komisionit do të nënshkruajë deklaratën, me anë të së cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me ofertuesit në përputhje me legjislacionin. Nëse një nga anëtarët e komisionit ka lidhje pune apo gjaku me një nga ofertuesit, atëherë kryetari i komisionit do t'i kërkojë Drejtorit të Përgjithshëm zëvendësimin e tij. Deri në emërimin e anëtarit

tjetër, komisioni nuk do të procedojë me vlerësimin e ofertave.

Neni 11

Operimi për shkëmbimin e energjisë elektrike

KESH sh.a. modifikon grafikun “muaj/javë/ditë në avancë”, në përputhje me nenet 12, 13, 14 të rregullave të tregut dhe ia paraqet OST sh.a. në përputhje me energjinë elektrike që do të shkëmbehet.

KESH sh.a. do t’i paraqesë OST sh.a. të gjitha marrëveshjet e shkëmbimeve.

OST sh.a. do të marrë të gjitha masat për zbatimin e grafikut të modifikuar “muaj/javë/ditë në avancë”.

Neni 12

Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi, me vendim të Bordit të Komisionerëve, sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.1183, datë 26.5.2006, shpall të zhdukur shtetasin Besnik Arif Verbofshi, i datëlindjes 16.1.1965, me datë zhdukjeje 26.4.1999.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2644, datë 16.11.2006, shpall të vdekur shtetasin Arben Adem Roda, i datëlindjes 25.4.1967, me datë vdekjeje 2.10.1997.

KËRKESË

Shtetasja Anila Kaferi, e bija e Gafurit dhe e Shazies, e datëlindjes 1975, lindur dhe banuese në Bllatë të Epërme, Maqellarë, Dibër, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Zenel Zabit Kaferi.

KËRKUESJA
Anila Kaferi

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... ...	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Doli nga shtypi më 19.1.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi 44 lekë